

një predhë eksplodoi shumë afër tyre. Që të tre pësuan në vend. U varrosën në oborrin e kishës ortodokse në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata N.G, FDH-465; deklarata G.Đ, FDH-5675; deklarata R.S, FDH-5689; deklarata Z.G, FDH-5694; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 90, 905; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Oteto četrdesetdvoje ljudi*, Oteta istina, num. 19, korrik-shtator 2009, 15, FDH-30424.

Emsale (Ilaz) Shala

(4.07.1967, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, referente, pjesëtare e UÇK-së)

Emsale Shala jetonte në bashkësi me prindërit në lagjen *Krstić*. Vëllezërit e saj, Agroni dhe Menderezi, jetonin dhe punonin në Gjermani. Ajo punonte si referente në ndërmarrjen *Silos*. Në fillim të muajit qershor të vitit 1998, ajo aderoi në UÇK. Ishte e angazhuar për logjistikë në shtabin e UÇK-së, i cili ishte i vendosur në vendin e quajtur *Carevc/Carevac*. Ishte e vetmja femër në njësitin e saj.

Kur forcat e UÇK-së e filluan betejën për pushtimin e qytetit, Emsala e armatosur me pistoletën e të atit, ishte në pozicionet mbi bjeshkën *Krstić*. Ditën e diel, më 19.07.1998, ajo shkoi në shtëpi për tu ndihmuar prindërve që të dilnin nga qyteti. Në largim e sipër me prindërit, kur arritën te vendi i quajtur *Bllato*, afro 3 kilometra larg **Rahovecit/Orahovac**, përpara u doli një grup policësh serbë. Ajo e kapi pistoletën e të atit, por ata ishin më të shpejt duke e qëlluar me dy plumba në stomak. Ka dhënë shpirt pas gjysmë ore. Me ndihmën e komshinjve, Aliut dhe Muharremit, i ati e ka bartur Emsalen deri te oborri i Muharremit, ku e varrosën të nesërmen në mëngjes. Në datën 10.12.1998, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e saj mortore në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata N.N, FDH-884; deklarata Xh.B, FDH-863; deklarata N.N, FDH-881; deklarata I.S, FDH-35290; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

Ramadan (Qerim) Abazibra

(17.02.1938, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, katër fëmijë)

Fatime (Sinan) Abazibra

(25.05.1942, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, katër fëmijë)

Magbule (Ramadan) Abazibra

(24.06.1976, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac)

Familjarët e Ramadan Abazibres e kanë braktisur shtëpinë e vet më 19.07. 1998, pasi në qytet filluan të dëgjoreshin krismat intensive nga të gjitha llojet e armëve. U nisën drejt vendit të quajtur *Bllato*. Edhe njerëz të tjerë iknin në të njëjtin drejtim. Afro 50 prej tyre arritën deri te vendi i quajtur *Tumbe* [**Rahovec/Orahovac**]. Përnjëherë, vërejtën se përreth tyre kishte shumë polici e ushtri. Disa prej tyre flisnin rusisht. Së pari, e ekzekutuan Ramadanin, e pas tij të bijën Magbulen. Bashkëshorten e Ramadanit, Fatimen, e qëlluan në kokë. Plumbat, po ashtu, ia kishin këputur tre gishtat. Trupat e të vrarëve kanë mbetur në vendin e vrasjes deri më 27.07.1998, kur familjarët dhe komshinjtë i bartën në qytet. Ramadanin e kanë varrosur në një varr, ndërsa Fatimen dhe Magbulen së bashku në varrin tjetër, në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac. Në datën 29.07.1999, mbetjet e tyre mortore u zhvarrosën dhe sërish u rivarrosën në varret e veçanta, në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata A.C, FDH-851; deklarata Xh.B, FDH-863; deklarata N.N, FDH-884; deklarata N.N, FDH-878; deklarata L.A, FDH-915; deklarata A.A, FDH-12926; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00614, FDH-35527.

Hazër (Sylejman) Rexha

(8.05.1932, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, taksist, gjashtë fëmijë)

Drita (Beqir) Rexha

(9.04.1973, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, rrobaqepëse, e pamartuar)

Pas hyrjes së njësiteve speciale policore